



**Përfshirja e elementeve të Agjendës së Gjelbër, Digjitalizimit,  
Hulumtimit dhe Inovacionit në programe studimore në  
Institucionet e Arsimit të Lartë-IAL në Kosovë**

**Prishtinë, 2024**

---

**Përgatitur nga:**

Muhamet Mustafa (Udhëheqës i projektit)  
Isuf Berisha  
Liridon Kryeziu  
Benet Maloku  
Alma Bajramaj

---

**Mbështetur nga:**



---

**Publikuar nga:**

RIINVEST INSTITUTE Lidhja e Prizrenit nr. 56  
Prishtina 10000, Republika e Kosovës Tel: + 381  
(0)38 244320 [www.riinvestinstitute.org](http://www.riinvestinstitute.org)

---

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve.

---

E drejta autoriale © 2024 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem reproduktimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa e cituar burimin.

---

## Përmbledhje Ekzekutive

Institucionet e Arsimit të Lartë-IAL po përballen me sfida të shumta, por edhe me mundësi të mëdha për përmirësim dhe avancim. Universitetet në vendet e BE janë duke bërë përpjekje të vazhdueshme për të përfshirë inovacionin dhe prioritetet e tjera të BE-së. Lidhur me këtë prioritetet e Agjendës së BE-së për Ballkanin Perëndimor (BP) , të cilat përfshijnë Hulumtimet dhe Inovacionet, Agjendën e Gjellbër dhe Digjitalizimin shtojnë kërkesa serioze edhe për vendet e BP dhe në veçanti për Kosovën. Ky Raport është , si një aktivitet në kuadër të Projekti nga Horizon Europe “Policy Answers” është përgatitur me qëllim që ti kontribuohet ngritjes së vetëdijes së IAL dhe akterëve tjerë përgjegjës për të zhvilluar një aktivitet sistematik në mënyrë që edhe IAL në Kosovë të zënë hapin e duhur në harmoni me këto zhvillime e kërkesa globale. Inovacioni në shumicën e programeve studimore është integruar në fusha të caktuara me një fokus të limituar dhe nuk është përfshirë në mënyrën e duhur në programet studimore. Sipas gjetjeve të anketës, respondentët e IAL-ve theksuan se lëndë e inovacionit do të integrohet dhe përfshihet në mënyrë direkte në fusha të ndryshme siç janë urbanizmi dhe planifikimi hapësinor, projektimin arkitektonik, trashëgiminë arkitekturale, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e performancës së ndërtesave, kriptografinë dhe inxhinierinë industriale.

Elementet e Agjendës të Gjellbër janë integruar vetëm në programe apo fakultete që mënyrë direkte apo indirekte kanë të bëjnë me temat e mjedisit. Në programet e tjera nuk janë përfshirë në mënyrë adekuate elementet e Agjendës së Gjellbër. Përrjashtim bëjnë disa programe përkatësisht lëndë ku sipas gjetjeve të anketës janë bërë disa hapa fillestarë. Megjithatë, mundësia që studentët të fitojnë shkathtësi të gjelbra që kërkohen në tregun e punës mbetet sfidauese.

Hulumtimi si lëndë është në të gjitha programet e IAL. Kjo lëndë ofron njohuri për studentët në lidhje me procesin se si të dizajnohet një studim, analizën e të dhënave, shkrimin e një punimi e kështu me rradhë. Megjithatë, në të gjitha syllabuset e vlerësuara mungon qasja ndërdisiplinore dhe praktike që do ti mundësonte studentëve që përveç kompetencave të fitojnë edhe aftësi që të bëjnë studime ndërdisiplinore.

Kompetencat digjitale nuk janë të integruara apo janë të integruara dobët me përjashtim të programeve nga fusha e fakulteteve teknike. Ndërsa sfidat kryesore të integrimit të digjitalizimit në programet universitare sipas përgjigjeve nga zyrtarët qëndrojnë në atë se ekziston mungesë e infrastrukturës qoftë si mungesë e pajisjeve të fundit apo e laboratorëve, stafit të kualifikuar, mospërshtatje e duhur ndaj ndryshimeve digjitale dhe fondeve të pamjaftueshme për investime në mjetet digjitale. Në disa lëndë të programeve të ndryshme ekzistojnë kompetenca digjitale që mund t'i përgatisin studentët për tregun e punës.

Ekzistojnë disa barriera që ndikojnë për përfshirjen e prioritetëve tematike në syllabuset e programeve të IAL. Këto janë, mungesa e financimit në infrastrukturë, në pajisje dhe laboratorë me qëllim të integrimit të pjesës teorike me atë praktike dhe posaçërisht mungesa e shkathtësive të stafit akademik për të ligjëruar në temat siç janë digjitalizimi, inovacioni dhe Agjenda e Gjellbër.

## Rekomandime

1. Kurrikula e programeve të Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) ndërlidhur me prioritete tematike të BE-së dhe Agjendës së BE për Ballkanin Perendimor duhet të dizajnohen bazuar në dialogun e vazhdueshëm me sektorin privat, politikëbërësit, donatorët dhe palët e tjera të interesuara të përfshira drejtpërdrejt ose tërthorazi. Në kuadër të kësaj të krijohen struktura mbështetëse të IAL dhe jo vetëm me qëllim të analizimit të kurrikulave që t'i përgjigjen më shpejtë dinamikave të kërkesave dhe nevojave të tregut të punës.

2. Kurrikulat të hartohen dhe përditësohen në linjë me Agjendën e Gjelbër, Digjitalizimin, Inovacionin dhe kultivimin e kërkimit aplikativ. Këto kurrikula të dizajnohen duke marrë parasysh dhe natyrën ndërdisiplinore që integron fusha të ndryshme, ndihmon studentët të fitojnë kompetenca dhe të vlerësojnë sfidat nga perspektiva të ndryshme.

3. IAL në bashkëpunim me akterët përgjegjës dhe të interesuar duhet të investojnë më shumë në zhvillimin e kapaciteteve të brendshme, siç janë infrastruktura, adoptimi i teknologjisë me qëllim të lehtësimit dhe përshpejtimit të aplikimit të komponentëve siç janë Agjenda e Gjelbër, Inovacioni, Hulumtimi dhe Digjitalizimi. Në kuadër të kësaj është esenciale të investohet në trajnimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, dhe të zhvillojnë kompetenca shtesë mësimdhënie që lidhen në temat e gjelbra, digjitalizimin dhe inovacionin.

4. Menaxhmenti i IAL t'i kushtojë vëmendje më të madhe informimit dhe sensibilizimit të mësimdhënësve mbi rëndësinë e integritit të Agjendës së Gjelbër, Digjitalizimit, Hulumtimeve dhe Inovacioneve në modulet e studimeve.

5. Të gjitha IAL të organizojnë trajnime dhe punëtori brenda tyre por edhe në bashkëpunim me njëra tjetrën për të inkuadruar në programet dhe kurrikulat e tyre fushat e përmendura më lartë. Rekomandohet MASHTI-t dhe donatorëve të involvuar në arsimin universitar që të mbështesin aktivitete e tilla.

6. IAL dhe institute tjera kërkimore si dhe asociacionet e biznesit të bashkëpunojnë për të arritur një integrim më të suksesshëm dhe më produktiv të Agjendës së Gjelbër, Digjitalizimit, Hulumtimeve dhe Inovacioneve në lëndët e studimeve të këtij IAL.

Tek IAL, në të gjitha fakultetet dhe departamentet veçanërisht duhet të ekzistojë qasja multi dhe ndërdisiplinore me qëllim të përfshirjes së këtyre fushave në punën e tyre akademike dhe kërkimore.

7. Rritja e përmbajtjeve dhe lëndëve nga fusha e **inovacionit** brenda kurrikulave, jo vetëm në fakultetet në fusha specifike por edhe në ato fakultete ku mund të kontribuojnë në nxitjen e inovacionit në vend dhe ngritjes të shkathtësive për studentët. Kjo kontribuon gjithashtu për krijimin e një ekosistemi inovativ efikas, krijimin e një kulture që inkurajon inovacionin, dhe sjellin përfitime të mëdha për shoqërinë.

8. Të përditësohen përmbajtjet e syllabuseve në lidhje me **digjitalizimin** me tema të reja duke u bazuar në trendet e zhvillimeve teknologjike. Në kuadër të kësaj, të përdoren softuerët dhe gjuhët

programuese siç janë Python dhe R, softuerët për vizualizim Tableau apo PowerBI dhe laboratorët virtual.

9. IAL-ët të avansojnë përmbajtjet dhe kurrikulat e tyre nga fusha e **hulumtimeve duke mos u reduktuar vetëm** në modulet e metodave kërkimore apo të shkathtësive akademike, por të përfshijnë edhe angazhimin e studentëve projekte kërkimore në bashkëpunim me industrinë dhe biznesin.

10. I rekomandohet KKSHC-së, përkatësisht Agjencinë të Akreditimit, që të inkuadrojnë këto fusha në kriteret edhe kërkesat për akreditim të IAL në vendin tonë.

## 1.Hyrje

Përfshirja adekuatë e përmbajtjeve nga Agjenda e Gjelbër, Digjitalizimi, Hulumentimi dhe Inovacioni në programet studimore është me rëndësi thelbësore për zhvillimin arsimit të lartë në Kosovë. Kjo jo vetëm nga shkak se tanimë Kosova ka marrë obligime dhe zotime lidhur me zbatimin e këtyre prioriteve në kuadër të Agjendës së BE për Ballkanin perëndimor, por edhe për faktin se kjo do të ketë rëndësi esenciale për përfshirjen më të suksesshme të Kosovës në Hapësirën e Arsimit të Lartë Evropian si dhe në Hapësirën Evropiane të Kërkimeve dhe Inovacioneve (ERA). Universitete dhe kolegjet kanë poashtu obligim që të inkuadrojnë përmbajtjet nga këto fusha në aktivitete e tyre kërkimore dhe të mësimdhënies për të ofruar një përvojë arsimore gjithëpërfshirëse që përgatit studentët me dije e shkathtësi që tu përgjigjen sfidat komplekse në planin vendor dhe global, të jenë konkurrues në epokën digjitale dhe të përgatitur që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë.

Qëllimi i këtij studimi është të kontribuojë për ngritjen e cilësisë së programeve në studimet universitare nëpërmjet pasurimit të tyre me komponentët e Agjendës të Gjelbër, Digjitalizimit dhe Hulumentimi dhe Inovacioni. Për këtë qëllim krahas ofrimit të informacioneve për situatën e aktuale jepen edhe rekomandime përkatëse me qëllimin shërbejnë gjithë akterëve të interesuar e sidomos si institucioneve qeveritare dhe institucioneve të IAL.

Ky raport është përgatitur në kuadër të aktiviteteve të Projektit Policy Answers (Politika që japin përgjigje, Horizon Europe) të cilin Instituti Riinvest e zbaton në Kosovë në kuadër të një konzorciumi të instituteve nga BE dhe instituteve nga rajoni. Ky aktivitet është në kuadër të Pakos të Punës 3 (WP3), që përfshinë veprimet specifike që ndërlidhen me 'Mbështetje në nxitjen e aktiviteteve në IAL për rishikimin dhe vlerësimin e kurrikulatve se si trajtohen çështjet prioritare që lidhen me Agjendën e Gjelbër, Transformimin Digjital, Hulumentimin dhe Inovacionin, përkatësisht që në këto programe të reflektohen qëllimet strategjike të Agjendës së BE-së .

Bashkimi Evropian ka trajtuar me prioritet fushat që ndërlidhen me shoqërinë e shëndetshme, digjitalizimin, agjendën e gjelbër dhe inovacionet dhe kërkimet për të siguruar një pozicion më të mirë konkurrues në planin global dhe arritur synimet për një mjedis jetese më të mirë dhe zhvillim të qëndrueshëm. Ky raport studimor përqendrohet vetëm në këto tri komponentë të lartpërmendura. Para një kohe Instituti Riinvest në kuadër të këtij projekti publikoi edhe raportin lidhur me problemet e shëndetësisë dhe digjitalizimin e këtij sektori.

Institucionet e Arsimit të Lartë, luajnë një rol të rëndësishëm në adresimin e objektivave strategjike të Bashkimit Evropian. Ndër veprimet e IAL, janë edhe dizajnimi i kurrikulave të programeve që ofrojnë shkathtësitë e kërkuara, me qëllim të përshpejtimit të arritjes të objektivave strategjike të vendosura. Integrimi i elementeve të Agjendës të Gjelbër, Digjitalizimit dhe Hulumentimi dhe Inovacionit në kurrikulë kërkon bashkëpunimin e ndryshëm të palëve të interesuara nga politikbërësit, IAL, sektori privat dhe ekspertët. Studime tregojnë rëndësinë e dizajnit të kurrikulës dhe programeve sipas këtyre komponentëve me qëllim që të mbështesin studentët të arrijnë aftësitë e nevojshme (Jain et al., 2013; OECD, 2024; Reichert, 2019).

Ky raport është përgatitur duke analizuar (1) Programet dhe syllabuset e publikuara në ueb-faqet të universiteteve publike dhe kolegjeve private në Kosovë dhe (2) intervistat e strukturuar me udhëheqës dhe ekspertë nga këto institucione (3) raste studimore të IAL në Bashkimin Evropian të përzgjedhura se si kanë zbatuar elemente të Agjendës të Gjelbër, Digjitalizimit dhe Hulumtimit dhe Inovacionit dhe një rast studimore nga IAL në Kosovë. Është analizuar gjendja në Universitetet kryesore në Kosovë duke u bazuar në listën e Agjencinë Kosovare të Akreditimit-AKA. Pas përzgjedhjes të listës të universiteteve, fillimisht janë skanuar ueb-sajtet nëse janë publikuar syllabuset. Në këtë fazë vlen të theksohet se syllabuset e kolegjeve private nuk kanë qenë të publikuara në ueb-faqet e tyre, ndërsa për dallim prej tyre vetëm një universitet publik nuk i ka publikuar syllabuset.

Për të siguruar përfshirje të IAL dhe përplotësuar informacionet është dizajnuar një pyetësor dhe u është dërguar IAL në Kosovë. Pyetësori është dizajnuar kryesisht rreth temave në masën që sa janë përfshirë elementet e Agjendës të Gjelbër, Digjitalizimit dhe Hulumtimit dhe Inovacionit në syllabuset në programet e këtyre institucioneve. Janë përgjigjur pozitivisht gjithsej gjashtëmbëdhjetë respondent, që përfshijnë rektorë, prorektorë dhe dekanë të IAL. Numri i IAL të përfshira në këtë fazë ka qenë tetë, nga katër respondentë nga IAL privat dhe publik.

Syllabuset janë analizuar duke u bazuar në metodologjinë e definuar duke u bazuar edhe në studime në vende të ndryshme. Së pari janë përcaktuar fjalët kyçe që ndërlidhën me këto komponente. Numri i programeve të vlerësuara të IAL të përfshira në studim janë 79, nga të cilat në nivelin e studimeve Bachelor 51, ndërsa në nivelin Master 40 dhe numri i syllabuseve të vlerësuara është gjithsej 1988. Në nivel të IAL, në Universitetin i Prishtinës 'Hasan Prishtina' janë vlerësuar më së shumti programe (49), module (462) në të dy nivelet Bachelor dhe Master (49), pasuar nga Universiteti 'Haxhi Zeka' më 14 programe dhe 368 syllabuse.

Instituti Riinvest falënderon IAL, udhëheqësit e tyre dhe pedagogët për bashkëpunimin e tyre në përgatitjen e këtij raporti dhe gjithashtu edhe Komisionin Evropian, përkatësisht HE për mbështetjen e këtij aktiviteti.

## **2. QASJET DHE ARRITJET NË VENDET E BE**

Shumica e Institucioneve e Arsimit të Lartë në BE kanë inkuadruar në programet kurrikulën e studimeve këto komponentë për të ofruar studentëve aftësitë e nevojshme lidhur me prioritetet tematike të angazhimeve brenda BE dhe partnerëve tyre. Kjo motivohet me nevojën që studentët gjatë studimeve të tyre të fitojnë dije dhe shkathtësi e të zhvillojnë aftësitë e tyre lidhur me transformimet thella që pritet të bëhen me zbatimin e të ashtuquajturit transmisionit dual - i gjelbër dhe digjital që do të jenë esenciale në kuadër të kërkesës së tregut të punës dhe nevojave të shoqërisë (VET Toolbox Coordination Hub, 2023).

Dizajnimi i kurrikulave që fokusohen në qasjen ndërdisiplinore në përcaktimin dhe zgjidhjen e problemeve të njohurive është i rëndësishëm. Studimi i Reichert, (2019) tregon rëndësinë e integritetit të kësaj qasje ndërdisiplinore në kurrikulat dhe metodat mësimore. Kjo është shumë e rëndësishme për të zbatuar ndjekur studimin e mësimin e bazuar në projekte dhe për të lidhur disiplinat shkencore teknologjike e madje edhe për të siguruar ndërlidhjen e nevojshme midis shkencave ekzakte dhe atyre

humane në zhvillimin teknologjik. Për shembull, programi në nivelin Master zhvilluar nga një konzorcium ndërkombëtar me qëllim të kombinimit të ICT-së, me fushat si ambienti, ekonomia dhe ndërgjegjësimi social. Ky program është zhvilluar me qëllim përmirësimin e aftësive të studentëve për të përshatur në zhvillimin e shpejtë të teknologjive të reja të ICT dhe t'i përgatisë ato për të fituar njohuri të reja (Klimova et al., 2016).

Asociacioni Evropian Universiteteve-AEU ka ofruar një udhërrëfyes për zbatimin e Marrëveshjes së Gjelbër që përbëhet nga katër komponentë: i) kërkimi dhe inovacioni për të nxitur kërkime multidisiplinore që synojnë të mbështesin zbatimin e zgjidhjeve të Marrëveshjes së Gjelbër. ii) Komponenti i arsimit dhe studentëve fokusohet në aftësitë që janë ndërdisiplinore dhe integron këto brenda një kurrikule të re, ku universitetet mund të ndryshojnë dhe ofrojnë trajnime për stafin dhe studentët dhe të rrisin kapacitetet e tyre; iii) Stafit dhe operacionet angazhohen për zbatimin e strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet përkushtimit për tu ballafaquar me emergjencën klimatike dhe duke rritur e vetëdijen për kode të sjelljes për stafin dhe akterët tjerë që të zgjedhin alternativa me emisione më të ulta; iv) Angazhimi publik dhe ndikimi shoqëror, përbëhet nga një vizion i qartë që universitetet duhet të kenë në zbatimin e Marrëveshjes së Gjelbër. Kjo kërkon ndërtimin e besimit me komunitetet dhe palët e tjera të interesuara, trajnimin për integrimin e njohurive dhe programet e studimit duke promovuar ndërlidhjen me komunitetin dhe e tjera të interesuara (European University Association, 2023).

Agjencia Daneze për Arsimit të Lartë dhe Shkencë ka publikuar një hartë (Roadmap) për përfshirje të përmbajtjeve nga Agjenda e Gjelbër në programet e studimit në IAL në Danimarkë në kuadër të investimeve në kërkimeve në lidhje me temat në kuadër të transicionit të gjelbër. Ky raport studimi thekson se vetëm 29 përqind e programeve të studimit kishin rezultate të rëndësishme të mësimin të ndërlidhur me transicionin e gjelbër, vetëm 22 përqind kishin të paktën një kurs obligues të lidhur me këtë, ndërsa 14 përqind kishin kurse opsionale. Për më tepër, tregon se ka pasur një sfidë në ndarjen midis rezultateve të mësimin të gjelbër dhe jo-gjelbër, çka solli një nevojë të rëndësishme për ndërtimin e definimeve të qarta dhe përputhjen strategjike për të rritur kompetencat për të mbështetur inovacionin nga transicioni gjelbër (OECD, 2024). Ky raport gjithashtu identifikoi shtatë tema që adresojnë sfidat e shoqërisë në lidhje me rezultatet e mësimin nga kjo fushë. Këto përfshijnë prodhimin e energjisë, përmirësimin e efikasitetit të energjisë, bujqësinë dhe prodhimin e ushqimit, transportin, mjedisin, ekonominë qarkore, natyrën dhe biodiversitetin dhe ndërlidhur me këtë edhe sjelljen qëndrueshme dhe pasojat sociale (Ministry of Higher Education and Science, 2024).

Studimi i Asociacionit Evropian të Universiteteve-AEU ka përfshirë 372 institucione të arsimit të lartë në Evropën e Zonës së Arsimit të Lartë Evropian (EHEA), të cilat tashmë janë në proces të zbatimit të masave dhe iniciativave të lidhura me Agjendën e Gjelbër. Rezultatet e anketës sugjerojnë se 64 përqind e institucioneve kanë aktivitete të që ndërlidhen me transicionin e gjelbër në institucione, 17 përqind e masave janë të bazuar në departament ose fakultet, ndërkaq 14 përqind e këtyre institucioneve konsiderojnë se do t'i zbatojnë ato në të ardhmen. Sipas studimit të Stöber et al., (2021) 80 përqind e institucioneve i konsiderojnë temat nga Agjenda e gjelbër si shumë të rëndësishme dhe duke përfshirë këto tema në aktivitetet e tyre jashtë kurrikulës. Rreth 94 përqind, kanë inkuadruar përmbajtje tek programet e studimeve Bachelor 79 përqind, ndërsa në programe Master rreth 82



përqind. Pjesa më madhe tyre rreth 86 përqind konsiderojnë reforma të mëtejme në kurrikula. Megjithatë, këto institucione kanë vlerësuar se sfidat kryesore mund të jenë mungesa e financimit dhe stafit akademik, vështirësitë në koordinimin e aktiviteteve, si dhe mungesa e mbështetjes strategjike.

Integrimi i aftësive digjitale në kurrikulë është kyç për shekullin e 21-të. Kompetencat Digjitale në fushën e TIK-ut mund të definoohen gjerësisht si “përdorimi i sigurt, kritik dhe kreativ i TIK-ut për të arritur qëllimet që lidhen me punën, punësueshmërinë, mësimin, kohën e lirë, përfshirjen dhe/ose pjesëmarrjen në shoqëri.” (Ferrari, 2012). Në kompetencat digjitale më saktësisht është i përfshirë aftësimi i duhur në përdorimin e programeve dhe pajisjeve teknologjike, sipas kërkesave të ambientit ku veprojnë individët (European Union, 2019). Kompetencat digjitale janë të cilësuar si një ndër kompetencat kyçe të jetës moderne, dhe luajnë rol të rëndësishëm në interaksionet e përditshme (DeSeCo, 2005). Rëndësia e posedimit të shkathtësive teknologjike tek punëtorët, duke përfshirë edhe njohjen e teknologjive specifike siç është Inteligjenca Artificiale, Të Dhënat e Mëdha (Big Data) dhe Siguria Kibernetike, pritet të rritet edhe më tepër gjatë pesë viteve të ardhshme (World Economic Forum, 2023). Kompetencat digjitale për shkak të rëndësisë që kanë aktualisht dhe rritjes së kërkesës të posedimit të tyre duhet patjetër të përfshihen në kurrikulat e universiteteve. Sipas hulumtimit të autorëve Sánchez-Caballé et al., (2021), të cilët analizuan syllabuset e një universiteti në Spanjë në lidhje me kompetencat digjitale, rezultoi se njohja teknologjike është më e integruar tek programet teknike, dhe se kjo është një kompetencë e rëndësishme që punëmarrësit e ardhshëm duhet patjetër të e posedojnë.

### **3. REZULATATE FILLESTARE NË PASURIM E PROGRAMEVE STUDIMORE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË ME PRIORITETET TEMATIKE TË BE-SË**

Bazuar nga analiza e programeve studimore në universitetet dhe fakultetet e paraqitura në Annex 2 si dhe përgjigjet në pyetësorin e bashkëngjitur në aneksin 3, del që në përjashtim të moduleve të hulumtimeve, komponentët e Agjendës të Gjelbër, Digjitalizimit dhe Inovacionit nuk janë përfshirë mjaftueshëm. Këto komponentë janë përfshirë kryesisht në programe të caktuara dhe mungon një qasje ndërdisiplinore. Megjithatë, gjetjet e anketës tregojnë që në shumicën e IAL ka filluar procesi i rishikimit të programeve mësimore të kurrikulave në harmoni me prioritetet tematike të Komisionit Evropian dhe Agjendës së BE-së për Ballkanin Perëndimor. Për t'i integruar prioritetet tematike, IAL në Kosovë janë duke hasur në barriera të ndryshme, siç janë: (i) mungesa e investimeve infrastrukturë siç janë në laboratorë dhe teknologji për të lehtësuar integrimin e elementeve të prioritetëve tematike; (ii) mungesa e ekspertizës dhe shkathtësive të stafit akademik për të ligjëruar temat si Inovacioni, Digjitalizimi dhe Agjenda e Gjelbër.

#### **3.1. Inovacioni në Programet Universitare**

Aktualisht, integrimi i inovacionit në programet studimore është modest si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga vëllimi. Kjo përbën një nga sfidat kryesore që arsimit të lartë në Kosovë po përballet. Kohëve të fundit janë shtuar përpjekjet për të përfshirë inovacionin në programet e tyre por ende ka shumë hapësirë për përmirësim dhe avancim. Në kuadër të zhvillimit dhe modernizimit të arsimit të lartë në Kosovë, inovacioni ka filluar të përfshihet në lëndët dhe modulet universitare. Rreth 75 përqind e pjesëmarrësve në anketën tonë kanë konfirmuar se tashmë kanë futur lëndë të reja në programet e

tyre mësimore, duke e bërë inovacionin një pjesë integrale të kurrikulave ose janë shprehur se kanë hapur diskutimin dhe janë në fillim të përgatitjeve. Inovacioni është integruar në disa lëndë, kryesisht në formë indirekte, duke përfshirë në fusha të ndryshme si hulumtimet dhe seminarët dhe lëndët e menaxhmentit dhe ndërmarrësisë. Kurse sipas përgjigjeve të dekanëve përkatës, inovacioni përfshihet drejtpërdrejtë në lëndët si: urbanizmin dhe planifikimin hapësinor, projektimin arkitektonik, trashëgiminë arkitekturale, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e performancës së ndërtesave, kriptografinë dhe inxhinierinë industriale.

Përpos integritit në lëndë e module, universitetet janë shprehur se po ndërmarrin iniciativë të ndryshme për përfshirje të inovacionit në forma të tjera si për shembull organizmi i konferencave mbi këtë tematikë, mundësimi i studentëve të ndjekin lënde të inovacionit në universitete të tjera partnere jashtë vendit por edhe janë si çështje të theksuara në strategjitë e universiteteve. Këto përpjekje tregojnë një përkushtim të qartë për të integruar praktikën më të mira dhe zhvillimet më të fundit në fushën e inovacionit.

Disa nga barrierat më të theksuara nga komentet shtesë të pjesëmarrësve në anketë fillojnë me idenë se personelit akademik i mungon ekspertiza e nevojshme në teknologjitë inovative, dhe mundësitë e zhvillimit profesional mund të jenë të kufizuara. Numri i vogël i profesorëve të specializuar në këto fusha dhe mungesa e investimeve e kapaciteteve përbëjnë pengesa të mëdha. Infrastruktura, pajisjet e vjetra dhe lidhjet e kufizuara të internetit janë gjithashtu sfida fatkeqësisht ende të pranishme në universitetet në Kosovë. Nga kjo shpesh herë rrjedh edhe rezistenca ndaj ndryshimeve brenda kulturës institucionale dhe sfidat rregullatore që gjithashtu ndikojnë në përfshirjen efektive të inovacionit. Kjo pasohet edhe me natyrën e karakterit financiar-fonde të pamjaftueshme dhe kostoja e lartë e zbatimit në praktikë të inovacionit në planprograme.

Në kuadër të hartimit të këtij studimi kemi analizuar syllabusët dhe lëndët përkatëse për të parë nëse përmbajnë ndonjë lloj inovacioni. Nga analiza jonë, rezultoi se inovacioni është integruar në një shkallë shumë të vogël. Këto gjetje tregojnë se, pavarësisht përpjekjeve ekzistuese, ka ende një nevojë të madhe për përmirësime të mëtejshme në këtë fushë. Edhe pse ndoshta inovacioni mund të diskutohet në klasa në ndonjë kontekst, nuk ekzistojnë lëndë të veçanta që përmbajnë fjalën "inovacion" apo tema të lidhura drejtpërdrejt me të. Mungesa e integritit së inovacionit në lëndë reflektohet në faktin se pjesa më e madhe e përmbajtjes së lëndëve bazohet kryesisht në prezantimin e teorive bazë, duke i munguar integrimi efektiv i inovacionit që mban ritmi i kohës. Kjo mungesë e lëndëve të dedikuara për inovacionin tregon një boshllëk në kurrikulat aktuale që duhet adresuar me urgjencë.

Për të filluar integrimin e inovacionit në programe, si nisje duhet të vlerësohen plotësisht kurrikulat aktuale të universiteteve dhe të identifikohen fushat që kanë nevojë për rishikim. Këtu është më rëndësi të angazhohen fakultetet, studentët dhe akterë të tjerë në diskutime rreth asaj se cilat aftësi dhe njohuri po bëhen më të rëndësishme çdo ditë e më shumë. Duhet të merret parasysh hendeku midis asaj që mësohet dhe nevojave të fuqisë punëtore moderne. Ky vlerësim duhet të jetë gjithëpërfshirës, duke shqyrtuar jo vetëm përmbajtjen, por edhe metodat e mësimdhënies dhe integrimin teknologjik. Kuptimi i këtyre nevojave është baza mbi të cilën mund të ndërtohet një kurrikulë më inovative.

Bashkëpunimin ndërdisiplinor në mes fakulteteve dhe departamenteve poashtu është një mënyrë për të integruar inovacionin. Qasjet ndërdisiplinore mund të stimulojnë kreativitetin dhe t'u ofrojnë studentëve këndvështrime të ndryshme. Kjo mund të nënkuptojë prezantimin e kurseve të reja ose rishikimin e atyre ekzistuese për të përfshirë tema të reja si inteligjenca artificiale. Integrimi i Inteligjencës Artificiale (IA) në programet studimore është thelbësor për të përgatitur studentët e Kosovës për tregun global të punës dhe për të nxitur inovacionin dhe hulumtimin. Për shembull, algoritmet e IA mund të personalizojnë mësimin duke përshtatur materialet mësimore sipas nevojave dhe stilit të të mësuarit të çdo studenti. Kjo mund të rrisë ndjeshëm efikasitetin dhe efektivitetin e edukimit, duke ndihmuar studentët të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Për më tepër, përfshirja e IA është një komponent kyç në zbatimin e Agjendës së Gjelbër dhe Digjitalizimit.

Mungesa e inovacionit si një lëndë i veçantë ose si temë brenda lëndëve tjera mund të lidhet me disponueshmërinë e personelit të specializuar në inovacion dhe pasurimin e këtyre kompetencave. Përveç kësaj, mungesa e lëndëve të inovacionit në institucionet e IAL është shqetësuese duke marrë në konsideratë faktin se inovacioni është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit në afate të shkurtër dhe të gjatë. Në disa raste, edhe pse nuk kishte lëndë të përbashkëta të inovacionit, ato lidheshin me tema të tjera. Megjithatë, edhe pse përqindja e ulët e këtyre lëndëve, çfarë shqetëson është përmasa në të cilën këto lëndëve të kufizuara mund të ndihmojnë studentët të fitojnë aftësi të inovacionit. Një pasojë e mundshme e mungesës së më shumë lëndëve të inovacionit në institucionet e IAL mund të jetë se kjo mund të ndikoj studentët të mos bëhen ndërmarrës dhe të zhvillojnë ide inovative.

Një faktor tjetër i rëndësishëm përse integrimi i lëndëve të inovacionit në IAL, mund të jetë se kjo krijon një inovacion për të ndërtuar një ekosistem inovativ efikas, duke çuar në një kulturë që inkurajon inovacionin në të gjitha nivelet e institucionit që rrjedhimisht sjellë përfitime më të larta për shoqërinë.

### **BOX 1: Technical University of Munich (TUM): Inkurajimi i Inovacionit përmes Zhvillimit Institucional dhe Kurrikulës**

Në TUM, është i përqendruar mësimi bazuar në projekte. Ky pastaj plotësohet nga ligjëratat mbi inovacionin dhe ndërmarrësin për të ngritur ndërgjegjen mbi mundësitë dhe sfidat. Këto përfshijnë tema si pronësia intelektuale dhe krijimi i bizneseve, tema që shpesh prezantohen nga ndërmarrës të suksesshëm. Ngjarjet që theksojnë fillimet inovative të start-up-ve mbahen për të nxitur ndërmarrësin, dhe të gjitha iniciativat ndërmarrëse mbështeten, duke përfshirë ato të udhëhequra nga studentët si Konkursi i Planit Biznesi i TUM-it. TUM promovon një kulturë inovacioni gjatë karrierës së një studenti, për të provuar ide të reja, një qëndrim pozitiv ndaj dështimit, dhe një gamë të gjerë kursesh që eksplorojnë proceset e inovacionit. Qendra për Teknologjinë dhe Menaxhimin Digjital (CDTM) ofron përvojë praktike përmes projekteve të jetës reale, duke nxitur bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe kultivimin e aftësive të rëndësishme të inovacionit dhe duke gjeneruar biznese të studentëve .

Dëna parakushte institucionale vlerësohen si të rëndësishme për të siguruar fleksibilitetin dhe adaptueshmërinë e dëshiruar për nevojat e inovacionit. Këto përfshijnë: i) një bazë të pasur kërkimore që mbështet inovacionin dhe mësimin bazuar në projekte; ii) raporte student-staf që bazohen në mbështetje individuale dhe mentorim në proceset e mësimin bazuar në projekte të tilla; iii) ndërveprim intensiv me industrinë dhe palët tjera të interesuara për të lejuar qasje në probleme të jetës reale për punën në projekte, si dhe për mentorim dhe staf mësimor i jashtëm; iv) një qeverisje që lejon organizimin modular dhe fleksibël të kursit; v) komunikim dhe bashkëpunim mes disiplinave dhe fakulteteve të ndryshme.

Karakteristikat institucionale vlerësohen të rëndësishme: i) kurse të shkurtra të përbashkëta, me fleksibilitet për të kombinuar tema të ndryshme në programe dhe trajtime të ndryshme; ii) një qendër trajnimi pedagogjik dhe inovacioni në mësim, e cila mund të sigurojë një përditësim të rregullt të trajnimit të stafit akademik dhe metodologjisë së mësimin dhe të mbështesë përdorimin e gjerë të metodologjisë së re të mësimin, duke përfshirë mësimin e orientuar nga projekti që integron disiplinat dhe departamentet e ndryshme; iii) zhvillim profesional i kurrikulës, me stafin mësimor universitar që mbështetet nga një shërbim bazuar në një vlerësim fillestar, pastaj zhvillohen i prototipe, ku prezantohen në një punëtori dhe përshtaten pas përgjigjeve të para, marketing ku studentet e marketingut që kërkojnë tregje për kurse në distancë, si pjesë e kurrikulës së tyre, dhe aprovimi akademik në senat, dhe vlerësimi i rregullt.

Burimi: Reichert (2019)

### 3.2. Agjenda e Gjelbër në Programet Universitare

Transicioni i gjelbër i universiteteve kuptohet si një rritje e ndërgjegjësimit dhe marrje e veprimeve konkrete drejt një universiteti të gjelbër, miqësor ndaj mjedisit dhe me efikasitet në përdorimin e burimeve (Stöber et al., 2021). Integrimi i temave “të gjelbra” në kurrikula është i rëndësishëm pas që rrit ndërgjegjësimin, ofron një mundësi të mirë për t’ju përgjigjur problemeve dhe sfidave në mënyrë më kreative (Jabbour et al., 2013).

“Temat e gjelbra” në IAL kryesisht janë të fokusuar në fakultete dhe programe të caktuara, ndërsa në fakultetet e tjera nuk janë të përfshira. Mungesa e ndërdisiplinaritetit është e dukshme në të gjitha planprograme dhe programe universitare. Temat e “gjelbra” kërkojnë ndërdisiplinaritet ndaj integrimi i tyre me një qasje ndërdisiplinore do të kishte një ndikim më të madh, jo vetëm në rritjen e ndërgjegjësimit të studentët, por edhe në integrimin e disiplinave të ndryshme në kuadër të këtyre programeve. Aktualisht në bazë të analizës të syllabuseve, programe janë të ‘ngurta’ sa i përket mundësisë për ndërdisiplinaritet, gjë që nuk ju mundëson studentëve t’i ekspozohen si duhet transicionit të gjelbër.

Gjetjet e analizës të syllabuseve janë në linjë me gjetjet e anketës. Përfaqësuesit e IAL, treguan se “temat e gjelbra” trajtohen në programe të caktuara dhe nuk ka një qasje gjithëpërfshirëse në të gjitha programe. Kjo për arsye se integrimi i këtyre temave brenda kurrikulës, kërkon një bashkëpunim dhe koordinim në mes të programeve dhe departamenteve, zhvillimin e një metodologjie të qartë, dhe definimin se çfarë aftësish dhe kompetencash lidhur me transformimin e gjelbër duhet të fitojnë studentët. Rrjedhimisht, fokusi i këtyre temave vetëm në programe të caktuara kanë ndikim negativ në zgjerimin e njohurive dhe aftësive të studentëve, nuk kontribuon krijimin e dijeve, dhe njohurive për një të ardhme të qëndrueshme sipas objektivave strategjike të Agjendës të Gjelbër.

Një tjetër gjetje me rëndësi është se edhe pse në programe të caktuara janë evidente temat e transicionit të gjelbër, këto përfshijnë tema në terme gjenerale, që nuk janë specifike dhe të qarta. Pra, kjo nuk reflekton në zhvillimin e aftësive dhe kompetencave praktike duke u bazuar në shembuj nga jeta reale në lidhje me sfidat mjedisore. Për shembull, në disa programe ka tema të lidhura me teknologjinë, dhe këto tema nuk janë integruar me problemet e transicionit të gjelbër që do tu mundësonin studentëve se si shfrytëzimi i teknologjisë do të ndihmonte për të zgjidhur probleme reale.

Mungesa e integritit të kompetencave nga transicioni dhe Agjenda e në planprograme nëpër disiplina ka pasojat e veta, pasi kjo mund të paraqesë një mundësi të humbur lidhur me bashkëpunimin multidisiplinor për të adresuar këto çështje. Kjo është e lidhur me kompleksitetin e Agjendës Gjelbër, e cila nuk përfshin vetëm 'tema të gjelbra', por gjithashtu përfshin përhapjen e teknologjive të reja inovative dhe digjitale për të adresuar këto çështje komplekse. Prandaj, duke analizuar këto planprograme si dhe gjetjet nga anketimi, shohim që studentët janë të kufizuar në terma të ekspozimit në lidhje me ndërdisiplinaritetin si dhe shumëllojshmërinë e zgjidhjeve që mund të zbatohen për të adresuar çështjet mjedisore. Andaj, fokusi në fusha ndërdisiplinore do të reflektonë në rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve dhe ofrimin të ideve kreative në zgjidhjen e shumë problemeve të

ndryshme mjedisore në vend. Për më tepër, lëndët nuk ofrojnë një dallim të qartë ca i përket mësimi të temave të gjelbra me tema gjenerale. Kjo nënkupton ndërlidhjen e këtyre temave që do t'i mundësonin studentëve të fitojnë aftësi të gjelbëria, që do t'i përgjigjeshin anës të kërkesës në tregun e punës.

Në gjetjet e anketës temat rëndësishme si ekonomia qarkore, dekarbonizimi, ndotja e mjedisit, energjia ripërtëritëse, sigurimi i ushqimit dhe biodiversiteti brenda IAL paraqetsin një pamje të fragmentare. Këto tema, nuk janë pjesë një kurrikule gjithëpërfshirëse dhe të integruar, këto tema shpesh gjenden të izoluar në programe specifike apo si pjesë e lëndëve individuale në shkencat natyrore. Për shembull, ekonomia qarkore është e integruar vetëm në tri institucione të arsimit të lartë (IAL), përkatësisht Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Prishtinës (UP) dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Ferizajt (USHAF) dhe RIT Kosova. Këto përpjekje janë të kufizuara dhe nuk adresojnë në mënyrë të mjaftueshme nevojën për një trajtim të gjerë dhe ndërdisiplinor të kësaj teme. Ndërkohë, ndotja e mjedisit dhe energjia ripërtëritëse trajtohen kryesisht në kontekste të caktuara si zhvillimi i qëndrueshëm dhe mungon një qasje sistematike që do të përfshinte këto çështje në të gjitha disiplinat përkatëse.

Ndotja e mjedisit, pavarësisht rëndësisë së saj, është përfshirë kryesisht në disa programe të shkencave natyrore dhe më pak në programe të tjera, duke reflektuar një qasje të ngushtë. Në të kundërt, energjia ripërtëritëse trajtohet në programet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit të biznesit, por jo në mënyrë të gjerë në inxhinierinë e ndërtimit apo ndërrmarisë. Sigurimi i ushqimit dhe biodiversiteti janë dy fusha kritike që ende nuk kanë gjetur vendin e tyre në programet aktuale arsimore, me përjashtim të planeve për akreditime të ardhshme. Kjo tregon një mungesë të përgatitjes adekuate të studentëve për t'u marrë me sfidat komplekse të lidhura me këto tema. Biodiversiteti, i cili është thelbësor për ruajtjen e ekosistemeve, trajtohet vetëm në kontekste të ngushta, si urbanizimi dhe planifikimi hapësinor, duke lënë një hendek të konsiderueshëm në edukimin ambiental.

Trajtimi i temave të ndërlidhura me mjedisin, edhe pse janë adresuar në disa programe, tregon për një nevojë të qartë për integrim më të thellë dhe ndërdisiplinor. Kjo mund të bëhet përmes një qasje gjithëpërfshirëse, me qëllim përgatitjen në mënyrë adekuate të studentëve për t'u përballur me sfidat globale që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e ambientit.

Në shembullin e ofruar më poshtë vërejmë përqendrimin e veçante që kanë “zgjidhjet e gjelbra” në plan programet e tyre, ku janë përfshirë lëndë të ndryshme që lidhen në mënyrë direkte dhe indirekte me temat e gjelbra. Kjo u ka ofruar mundësi studentëve që t'i analizojnë problemet nga perspektiva të ndryshme dhe të ofrojnë zgjidhje reale të problemeve. Në kuadër të kësaj, përmes ndërdisiplinartetit dhe projekteve të ofruara, mundësohet krijimi i aftësive ndërdisiplinore tek studentët për të adresuar sfidat mjedisore në mënyrë më efektive. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është edhe përqendrimi në aftësi konkrete dhe praktike që ofron programi. Kjo organizohet përmes zhvillimit të aftësive praktike në fushën e transicionit të gjelbër. Për fund, bashkëpunimi i ngushtë me industrinë dhe zbatimi në praktikë i njohurive të fituara nga studentët është një mundësi e mire. Kjo bëhet përmes inkurajimit të

projekteve reale që krijohen në bashkëpunim me stafin akademik, studentët dhe bizneset për të ofruar zgjidhje konkrete për bizneset.

**BOX2: University College Nordjylland (UCN), Danimark :** Dizajnimi i programeve sipas Zgjidhjeve të Gjelbra

Universiteti Nordjylland (UCN) krijoi një program të përqendruar në zgjidhjet e gjelbra, duke rritur numrin e lëndëve të lidhura me prodhimin e energjisë, efikasitetin, mjedisin, ekonominë qarkore, natyrën, biodiversitetin, sjelljen e qëndrueshme dhe ndikimet shoqërore. Duke njohur rëndësinë e tranzicionit të gjelbër në ndërtim, UCN integroi elementet e gjelbra në kurrikul që në vitin e parë përmes projekteve ndërdisiplinore dhe kurseve opsionale. Programi përgatit studentët për sfidat e tregut të punës duke kërkuar elemente të gjelbra në projektet e tyre.

**Përmbajtjet nga trasicioni i gjelbër në arsim:** Programi përfshin projekte ndërdisiplinore semestrale, duke filluar me dizajnimin e një shtëpie të veçuar dhe duke avancuar drejt një apartamenti. Një praktikë e detyrueshme gjithashtu përfshin elemente të gjelbra në të gjitha lëndët dhe projektet, duke treguar se si studentët përmirësojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e tyre në tranzicionin e gjelbër me kalimin e kohës.

**Një gamë gjerë në zgjidhjet e gjelbra u ofron studentëve mundësi të shumta gjatë dhe pas studimeve të tyre.**

Programi përputhet me të gjitha 17 qëllimet globale të OKB-së, duke përfshirë ujin e pastër, adaptimin ndaj klimës, energjinë e qëndrueshme dhe konsumimin dhe prodhimin e përgjegjshëm. Kurrikula evoluon me tendencat dhe njohuritë e reja, të mbështetura nga Molio—qendra e njohurive të industrisë së ndërtimit. Programi gjithashtu përfshin trajnime mbi CLT (Dru të Laminuar Kryq) për ndërtimin e kateve prej druri masiv, të integruara në arsim.

**Rezultatet e të mësimit për temat e gjelbërta për studentët.** Stafi akademik thekson rëndësinë e ndërtimit në përshtatjen ndaj klimës, duke i motivuar studentët të kontribuojnë me zgjidhje. Shumica përqendrohen te tranzicionet e gjelbra, duke përfshirë qarkullimin, ripërdorimin dhe riciklimin e materialeve, analizën e ciklit të jetës, materialet e qëndrueshme dhe betoni i gjelbër, veçanërisht në kurset opsionale dhe projektet e diplomimit. Studentët fitojnë aftësi në dizajnin e energjisë, vlerësimin e ciklit të jetës, rinovimin dhe materialet e qëndrueshme, si dhe mësojnë për digjitalizimin e proceseve të ndërtimit, strategjinë dhe menaxhimin. Për shembull, ata studiojnë tjegullat e çatave me panele diellore të integruara dhe mësojnë të kryejnë analiza të ciklit të jetës, duke vlerësuar ripërdorshmërinë e materialeve, transportin dhe ndikimin klimatik. Kur dizajnojnë një shtëpi të veçuar, ata kuptojnë se tullat e pjekura dy herë kërkojnë dy herë më shumë energji sesa tullat e zakonshme.

**Studentët mësojnë të menaxhojnë proceset e ndërtimit të gjelbër për të përmbushur kërkesat e rritura për ndërtimin e qëndrueshëm.** Ata trajnohen në metoda të bashkëpunimit fleksibël dhe në menaxhimin e materialeve, proceseve, konsumit të energjisë dhe përdorimit të ndërtesave sipas standardeve më të fundit të emetimeve të CO<sub>2</sub>. Qëllimi është të sigurohet që ndërtesat janë sa më të gjelbra të jetë e mundur me emetime minimale të CO<sub>2</sub> gjatë të gjithë procesit të ndërtimit dhe përdorimit. Studentët gjithashtu mësojnë të identifikojnë rastet e biznesit të gjelbër të fitueshëm. Ata mësojnë rëndësinë e kritikës së burimeve, aftësitë analitike dhe llogaritjen e ndikimeve ekonomike dhe klimatike. Ky parashikim u mundëson atyre të promovojnë rregullimet e gjelbër në fuqinë punëtore, duke treguar përfitueshmërinë e tranzicionit të gjelbër për prodhuesit dhe kontraktorët.

**Kontributi në tranzicionin e gjelbër:** Kur studentët mbarojnë studimet, ata mund të kontribuojnë në tranzicionin e gjelbër në projekte konkrete të ndërtimit. Universiteti është në kontakt të ngushtë me Ndërtojmë Danimarkën (ËBD), i cili në fjalët e tij të veta është "Një pikë takimi e re për të gjithë në industrinë e ndërtimit që dëshiron njohuri dhe bashkëpunim në inovacion, tranzicionin e gjelbër dhe teknologjinë e re." ËBD dhe UCN janë në fazën fillestare për të lidhur kompanitë që kanë sfida me tranzicionin e gjelbër me studentët që në projektet e tyre të fundit përpiqen të zgjidhin problemet. Është një "fitore për të dyja palët".

### 3.3. Digjitalizimi në Programet Universitare

Nga anketa e realizuar me zyrtarët nga Universiteti i Prishtinës dhe Institucione tjera të Arsimit të Lartë, del se ka filluar procesi i inkuadrimit të lëndëve që përfshijnë fushat e digjitalizimit. Sipas përgjigjeve nga zyrtarët e Universitetit të Prishtinës elementi digjital është i integruar në programin e shkencave kompjuterike si dhe ka përfaqësim në programet e tjera përmes lëndëve të caktuara siç janë: Ekonomiksi Digjital, Informatika e aplikuar, Programimi, GIS, Hartografi, Digjitalizimi i Prodhimeve, Zhvillimi i web aplikacioneve, dhe lëndë të tjera; kështu duke qenë në linjë edhe me gjetjet nga analiza jonë e syllabusëve të publikuar. Një risi nga përgjigja e një zyrtari nga një IAL sa i përket digjitalizimit është se në lëndë të caktuar të programeve shëndetësore ata kanë inkuadruar edhe teknologji siç është Realiteti Virtual (VR).

Sipas rezultateve të anketës përceptimet e zyrtarëve rreth sfidave apo barrierave ishin pothuajse të njëjta si për Universitetet Publike ashtu edhe për Institucionet e tjera të Arsimit të Lartë. Ndër sfidat kryesore të identifikuar rezultuan: mungesa e fondeve dhe investimeve të mjaftueshme, mungesa e pajisjeve të duhura teknike-digjitale, deficit i shkathësive digjitale tek stafi akademik, dhe pasiguria rreth ndryshimeve në zhvillimet digjitale. Duhet shtuar gjithashtu se sipas opinionit të zyrtarëve të Institucioneve të tjera të Arsimit të Lartë, digjitalizimi është element përmes inkuadrimit të së cilit mund të arrihet në ballafaqimin e duhur me sfidat bashkëkohore globale.

Nga një analizë e përgjithshme e niveleve Bachelor dhe Master të Universitetit të Prishtinës, rezultoi se kompetencat digjitale nuk janë të integruara apo janë të integruara dobët me përjashtim të fakulteteve që kishin programe teknike. Ndër fakultetet e përfshira në analizën rreth kompetencës digjitale në Universitetin e Prishtinës janë Fakulteti Ekonomik, Shkencave-Matematiko Natyrore, Mjekësisë, Juridik, Filozofik si dhe i Arkitekturës.

Sa i përket kompetencës digjitale, ajo është integruar mjaft pak në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, përveç në programe të veçanta nga ky fakultet. Ndër programet me integrimin më të lartë të kompetencës digjitale në analizë, rezultoi programi i Shkencave Kompjuterike, si dhe Programi i Matematikës Financiare, respektivisht. Në këto programe, elementi digjital ishte i shprehur nëpërmjet mësimit të bazës së teorive digjitale, arkitekturës kompjuterike, sistemeve operative, gjuhëve programuese, algoritmeve, si dhe implementimit të tyre për të krijuar aplikacione apo softuerë si pjesë e projekteve studimore. Gjithashtu në këto programe ekzistojnë lëndë ku ofrohet njohuri në softuerët për përpunim dhe analizë të të dhënave, njohjes së koncepteve rreth bazave të të dhënave, si dhe gjuhëve programuese për menaxhimin e tyre, softuerëve për dizajnim vizual, si dhe përdorimin apo njohjen e teknologjive-koncepteve siç është: Biznesi Elektronik (E-commerce), Inteligjenca Artificiale (Artificial Intelligence), Siguria kibernetike, apo Interneti i Gjërave (Internet of Things). Përveç njohjes dhe mësimit të veglave digjitale, në programet e tjera të Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore siç janë ato të Kimisë, Kimisë Inxhinierike dhe Ekologjisë, në lëndët ku ekzistonte njohja e kompetencave digjitale, ajo ishte e shprehur kryesisht nëpërmjet familjarizimit për përdorimin e pajisjeve të gjeonavigacionit apo matjeve hapësinore, njohjen e pajisjeve për matje të fenomeneve fiziko-natyrore, përdorimin e softuerëve për analizë dhe interpretim të të dhënave, softuerëve për menaxhim të projekteve, si dhe në njohjen e shfrytëzimit të internetit për nxjerrjen e informacioneve.



Sa i përket fakultetit të Arkitekturës, komponenti digjital është shprehur në lëndë të caktuara, të cilat lidhen kryesisht me mësimin dhe përdorimin e softuerëve për dizajnim, siç janë softuerët CAD, softuerëve për matje hapësinore, si dhe lloje të gjuhëve programuese për punë me të dhëna. Duhet theksuar se lëndët në këtë drejtim, të cilat nuk kishin karakter digjital, nuk kanë fare të integruar kompetencën digjitale në syllabuset e tyre.

Poashtu edhe në fakultetin e Edukimit në shumicën e lëndëve kishte mungesë të kompetencave digjitale, me përjashtim të lëndëve të caktuara. Një tipar më i veçantë i këtij fakulteti sa i përket kompetencave digjitale, ishin lëndët e caktuara që kishin të përfshira aspektet teorike të mësimdhënies digjitale-në distancë.

Një fakultet tjetër ku elementi digjital mungonte, porse që kishte lëndë të caktuara ku ishte prezent ishte edhe ai i mjekësisë. Në këtë kompetencat digjitale më tepër ishin të shfaqura përmes mëimit dhe përdorimit të pajisjeve digjitale mjekësore. Ndër pajisjet që janë të cekura janë ato që kanë të bëjnë me diagnostikimin e sëmundjeve siç janë aparaturat digjitale radiologjike dhe me ultratinguj të cilat bëjnë shfaqje imazherike. Në lëndët tjera si ato me përmbajtje statistikore dhe informatike ishte në theks zbatimi i softuerëve për përpunimin dhe analizën e të dhënave, njohjen bazike të softuerëve aplikativ, njohjen bazike të shfrytëzimit të internetit për marrjen e informatave, dhe në lëndë të caktuara edhe njohuri teorike mbi kirurgjinë robotike. Duhet theksuar se në programin e farmacisë nga ky fakultet ka lëndë, në të cilat ofrohet njohja e softuerëve të caktuar për të bërë modelimin e strukturave kimike, nanoteknologjisë, përdorimit të Inteligjencës Artificiale në fushën farmaceutike dhe ofrimin e njohurive në identifikimin e bazave të të dhënave relevante.

Në Fakultetin Ekonomik të UP-së digjitalizimi i shprehur në lëndë të caktuara siç janë informatika, statistika, ekonometria; dhe në disa lëndë në veçanti në këtë fakultet ka pasur përfshirje edhe të koncepteve bashkëkohore teknologjike, siç janë Inteligjenca Artificiale, Blockchain, Machine Learning, E-Marketingu, përdorimi i rrjeteve sociale dhe përdorimi i digjitalizimit në financa. Në Fakulteti Ekonomik gjithashtu koncepti i bazës së të dhënave është i shprehur në lëndë të veçanta ku kërkohet analiza dhe modelimi i tyre, përmes shfrytëzimit të softuerëve të caktuar, dhe mëimit të gjuhëve programuese siç janë Python apo R që përdoren në fushën e të dhënave. Megjithatë pavarësisht pjesëmarrjes adekuate në lëndë të caktuara të digjitalizimit duhet theksuar se në përgjithësi në të gjitha programet e fakulteti ka pjesëmarrje të ulët.

Më tutje edhe në fakultetin juridik, në shumicën e lëndëve ka munguar elementi digjital, ku në shumicën e lëndëve përdorimi apo mësimi i softuerëve nuk ka qenë i pranishëm. Megjithatë, në një lëndë në këtë fakultet ka pasur integrim adekuat të digjitalizimit, i cili ishte i shprehur nëpërmjet mëimit të softuerëve për grupim-interpretim të të dhënave.

### **BOX 3: Universiteti i Varshavës: Inkurajimi i aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve në mënyrë të pavarur.**

Në Universitetin e Varshavës, nismat e fundit plotësojnë mësimdhënien tradicionale duke nxitur mësimin e pavarur, në grup dhe të bazuar në projekte. Këto programe zhvillojnë sistematikisht aftësitë analitike dhe të zgjidhjes së problemeve, ndërsa promovojnë qëndrimet ndërmarrëse përmes iniciativave, vetë-organizimit dhe punës në grup. Inkurajimi i mendimit krijues për të motivuar studentët të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe të përdorin aftësitë analitike për zgjidhjen e problemeve. Po ashtu këto programe synojnë të rrisin atraktivitetin e programeve dhe të përmirësojnë punësimin e të diplomuarve.

Në nivelin Master, në lëndën "idetë dhe informatika" dizajnuar për grupe të përziera studentësh në shkencë kompjuterike dhe fusha të tjera synon të përcjellë një gamë të gjerë inovacioni. Pjesëmarrësit propozojnë ide, i diskutojnë ato nga perspektiva të ndryshme, propozojnë aftësitë që sjellin për zhvillimin e mëtejshëm dhe më pas formojnë ekipe për të zhvilluar një ide të një projekti që mund të realizohet në praktikë. Kështu, studentët kalojnë nëpër procesin e trajtimit të sfidave ekonomike, pyetjeve, hapave dhe analizës së tregut. Në fund ata duhet të paraqesin një propozim për një biznes, pas së cilës një numër i vogël zgjidhet për vazhdim.

Programi përfshin klasa të ligjëruara dhe udhëhequra nga menaxherët e bizneseve të vogla. Edhe pse programi është ende në periudhën e tij të parë provuese, suksesi i të diplomuarve të tij është tashmë i dukshëm: 700 të diplomuarit e grupit të parë ofruan një profil të pazakontë, duke kombinuar kuptimin analitik të konteksteve kulturore njerëzore me aftësi IT dhe ndërgjegjësim ndërdisiplinor për problemet — gjë që rezultoi të ishte shumë tërheqëse për kompanitë. Kërkesa e fortë nga studentët gjithashtu tregon se sa tërheqëse janë për përvojat e tilla profesionale të rëndësishme në kurrikulat universitare të bazuara në teori.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike ka prezantuar një drejtim opsional në programin e Masterit për të nxitur ndërgjegjësimin për kërkesat ekonomike dhe sfidat e biznesit midis studentëve të shkencave kompjuterike; ose programin e Humaniteteve në Teknologjitë e Reja (or the Humanities in New Technologies programme) ose projektet sfiduese të Fakultetit të Fizikës që promovojnë aftësitë e pavarura të zgjidhjes së problemeve.

Burimi: Reichert (2019)

### **3.4. Hulumtimet dhe inovacionet**

Hulumtimet shkencore janë veprimtari me rëndësi fundamentale që janë bazë e zhvillimit teknologjik, ekonomik, arsimor, kulturor e të përgjithshëm social të një vendi. Për fat të keq, Kosova sot është në fund të listës së vendeve të Ballkanit Perëndimor për sa i përket zhvillimit të sektorit të hulumtimeve shkencore. Prandaj nuk është për t'u habitur që ajo mbetet poashtu e fundit në rajon edhe sa i përket zhvillimit ekonomik.

Sektori i hulumtimeve në Kosovë pas vitit 1999 është zhvilluar kryesisht në mënyrë stihike, pa mbështetje të qëndrueshme me fonde të mjaftueshme dhe vizion të qartë të zhvillimit nga ana e Qeverisë së Kosovës/QK. Strategjia e parë e pasluftës e këtij sektori, Programi Kombëtar i Shkencës i vitit 2010, në pjesën e tij më të madhe dhe më të rëndësishme mbeti i pa implementuar. Strategjia më e re, Programi Kombëtar i Shkencës (2023), edhe pse me buxhet dhe ambicie të rritura, ka marrë vërejtje për mënyrën e hartimit, për mungesë të diskutimit të mirëfilltë publik rreth tij, për disa nga projektet kryesore në të cilat është planifikuar shpenzimi i pjesës më të madhe të buxhetit, për vizion deficitar të zhvillimit të këtij sektori, etj.

Në këtë kontekst jo edhe aq frymëzues dhe mbështetës janë zhvilluar edhe përpjekjet e kundërthënëshme apo përpelitjet e IAL-ve rreth sektorit të hulumtimeve. IAL-ët në këto rrethana janë përshtatur duke u koncentruar kryesisht në mësimdhënie, ndërsa hulumtimet janë lënë pas dore, përkatësisht si aktivitete të individëve entuziastë.

Shembull ilustrativ për këtë mund të mirret, fjala vjen, Universiteti i Prishtinës, IAL më i madh dhe dominues i skenës së arsimit të lartë në Kosovë, që ka numrin më të madh të mësimdhënësve dhe hulumtuesve aktivë apo potencialë në Kosovë. Megjithatë, ende statuti i këtij IAL, duhet të avancohet me qëllim mbështetjen e hulumtimeve shkencore të mësimdhënësve, meqë për angazhimin e tyre në projekte kërkimore ata nuk janë stimuluar as financiarisht, as me zvogëlim të orëve të mësimdhënies.

Prandaj kur flasim këtu për integrim të hulumtimeve në IAL-ët në Kosovë, ne po flasim para së gjithash për nivelin e përfshirjes së këtij segmenti të prioritetëve zhvillimore të BE-së në kurrkulat e universiteteve dhe kolegjeve të arsimit të lartë në Kosovë me synimin të përgatitjes së studentëve të këtyre institucioneve me njohuri dhe shkathtësi të domosdoshme për hulumtime dhe shkruarje të punimeve shkollore apo akademike.

Pothuaj të gjitha programet e studimeve të universiteteve dhe kolegjeve që kemi analizuar kanë të paktën një modul për metodat e hulumtimeve, qoftë edhe të formatit të shkathtësive akademike për studentë të viteve të para studimeve paradiplomike. Në të shumtën e rasteve këto module vlerësohen me nga 6 ECT, por ndonjëherë edhe me 3 ECT (Fakulteti i ndërtimtarisë i UP, i cili poashtu ka modul të këtij profili që "peshon" 6 ECT) ose 4 ECT (Fakulteti i arkitekturës i UP), 7 ECT (Fakulteti filozofik i UP), ndërsa në Kolegjin AAB moduli Metodave të hulumtimit shkencor vlerësohet me 8 ECT.

Kur është fjala për rëndësinë që disa nga IAL-ët në Kosovë iu kushtojnë hulumtimeve, përkatësisht përgatitjes së studentëve të tyre me njohuri dhe shkathtësi për realizimin e kërkimeve, nga intervistat tona del se një zyrtarë e ish AUK-ut apo RIT në Kosovë ka listuar katër module të metodave të hulumtimit të cilat studentët e këtij IAL-i i vijojnë në nivele të apo programe të ndryshme të studimeve.<sup>1</sup> Ngjashëm, fjala vjen, përfaqësuesi i Fakultetit filozofik të UP në përgjigjet e tij në anketën tonë ka listuar tri module të ndryshme për metodat e hulumtimeve.<sup>2</sup> Nga ana tjetër, në pothuaj të gjitha programet e studimeve të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj mund të gjejmë një apo dy module të ndryshme që kanë të bëjnë me hulumtimet<sup>3</sup>.

#### **4. Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj**

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) është marrë për tu prezantuar si rast studimi duke u nisur nga struktura programore e tij ku përfshihen shkenca sociale dhe tekniko teknologjike me një hapësirë të konsiderueshme për të inkuadruar fushat tematike prioritare që i trajton ky raport.

---

<sup>1</sup> Përgjigje në anketën e Institutit Riinvest.

<sup>2</sup> Përgjigje në anketën e Institutit Riinvest.

<sup>3</sup> Shembull: Statistik, Modele Statistikore, Metoda kërkimore, Shkathesi Akademike

Gjithashtu spikatën angazhimet e këtij institucioni kur është fjala për përfshirjen Agjendës së Gjelbër, transformimit digjital, hulumtimeve dhe inovacionit në planprogramet mësimore të studimeve të veta themelore dhe Master.

Pikë së pari, karakteri i studimeve, përkatësisht synimi që, siç e sygjeron edhe vetë emri i këtij IAL, studentët gjatë studimeve të tyre të aftësohen për zbatimin e dijeve të fituara në fushat përkatëse të industrisë, ka bërë që në USHAF t'i kushtohet vëmendje e posaçme ndërlidhjes së teorisë me praktikën dhe në lidhje me këtë hulumtimit dhe inovacionit.

Rrjedhimisht, në USHAF përfshirja e Agjendës së Gjelbër, transformimit digjital, hulumtimeve dhe inovacionit në planprogramet mësimore është realizuar në mënyrë më sistematike dhe më të plotë se sa në shumicën e IAL-ve tjera në Kosovë.

#### **4.1. Analiza e programeve të studimeve dhe syllabuseve**

USHAF ka pesë fakultete, me programet studimore të të cilave është synuar që të adresohen nevojat e tregut të punës për kuadro të kualifikuara në fushë të industrisë dhe biznesit. Këto janë: 1. Fakulteti i menaxhmentit, 2. Fakulteti i inxhinierisë dhe informatikës, 3. Fakulteti i arkitekturës, dizajnit dhe teknologjisë së drurit, 4. Fakulteti i turizmit dhe ambientit, dhe 5. Fakulteti i arteve të aplikuara. Në kuadër të Fakultetit të menaxhmentit është hapur programi i studimeve paradiplomike (Bachelor) Menaxhimi i biznesit dhe ndërmarrësia.

Agjenda e Gjelbër është integruar në mënyrë adekuate në dy module që i kushtohen kësaj problematike, ndërsa në katër lëndë të tjera kjo tematikë është integruar pjesërisht.<sup>4</sup> Transformimi digjital është integruar në mënyrë adekuate në pesë module, kurse në gjashtë të tjera mund të flasim për integrim të pjesërishtëm të kësaj agjende. Përgatitja e studentëve për hulumtime adresohet në mënyrë adekuate me një lëndë të veçantë për këtë problematikë, ndërkaq në tre (3) module të tjera kjo problematikë është integruar pjesërisht. Problematika e inovacioneve është integruar në mënyrë adekuate në katër (4) module të këtij programi të studimeve, ndërsa në tetë (8) të tjerë pjesërisht, apo si komponentë ose vlerë e shtuar e tematikës kryesore të modulit.

Pra në 32 nga 41 module të këtij programi të studimeve të Fakultetit të menaxhmentit të USHAF Agjenda e Gjelbër, ajo e transformimit digjital, e hulumtimeve si dhe ajo e inovacioneve janë integruar në mënyrë adekuate apo të pjesërishtëm, ndërsa në syllabuset e nëntë (9) moduleve tjera nuk shihet ndonjë gjurmë e integritimit apo vëmendjes ndaj këtyre komponenteve prioritare të BE të zhvillimit të ekonomive dhe shoqërive bashkëkohore evropiane.

---

<sup>4</sup> Integrim adekuat të ndonjëres nga katër prioritetet e përmendura të agjendës së BE-së kemi kur atij komponenti i është kushtuar modul i veçantë, ndërsa për integrim të pjesërishtëm flasim kur ky prioritet është përfshirë apo e përshkon modulën e caktuar si vlerë e shtuar.

Programi i parë i studimeve, ai i Inxhinierisë industriale me informatikë ka 42 module. Agjenda e Gjellbër është integruar në mënyrë adekuate në dy (2) nga këto module, ndërsa në një modul tjetër mund të flasim për integrim të pjesërishëm të kësaj problematike. Vetëkuptohet që vëmendje më të madhe në këtë drejtim të studimeve i është kushtuar problematikës së digjitalizimit, e cila është integruar në mënyrë adekuate në nëntë (9) module, ndërsa në tri (3) të tjera pjesërisht. Hulumtimet janë integruar në mënyrë adekuate në një lëndë të veçantë për këtë problematikë, kurse në dy module të tjera ajo është integruar pjesërisht. Poashtu, edhe problematika e inovacioneve ka integrim adekuat në një modul, ndërsa në dy të tjera të pjesërishëm. Siç mund të shihet, vetëm në 21 module të këtij programi të studimeve prioritetet e agjendës evropiane që kanë të bëjnë me Agjendën e Gjellbër, Digjitalizimin, Hulumtimet dhe Inovacionet janë integruar në mënyrë adekuate apo pjesërisht, ndërsa në po aq apo 21 kurikula të moduleve të tjera nuk shohim vëmendje të artikuluar ndaj këtyre katër prioritetëve zhvillimore.

Drejtimi tjetër i studimeve i Fakultetit të inxhinierisë dhe informatikës, ai Informatikës së aplikuar ka 41 module. Në asnjë prej tyre nuk e shohim të integruar Agjendën e Gjellbër, qoftë edhe pjesërisht. Vëmendje e veçantë në këtë drejtim të studimeve i është kushtuar digjitalizimit, i cili është integruar në mënyrë adekuate madje në 23 module. Në këtë program studimesh hulumtimet janë integruar në mënyrë adekuate në dy module të veçanta, ndërsa në një lëndë tjetër kjo problematikë është integruar pjesërisht. E ngjashme është gjendja edhe me inovacionet, me integrim adekuat në një modul, ndërsa në një tjetër me integrim të pjesërishëm. Pra, në 28 nga 41 module të këtij drejtimi të studimeve katër prioritetet e agjendës evropiane janë integruar në mënyrë adekuate apo pjesërisht, ndërsa në 13 modulet tjera nuk shohim ndonjë vëmendje apo integrim të agjendës në fjalë.

Programi i studimeve paradiplomike, Arkitektura e interiorit dhe dizajni i mobilieve, ka 41 module. Agjenda e Gjellbër është integruar në mënyrë adekuate në një modul, ndërsa në dy të tjerë pjesërisht. Digjitalizimin e gjejmë të integruar në mënyrë adekuate në tre (3) module, ndërsa në nëntë (9) lëndë të tjera ky integrim është i pjesërishëm. Pa modul të veçantë për metodat kërkimore, problematika e hulumtimeve është integruar pjesërisht vetëm në dy module. Gjendja duket më e mire sa i përket problematikës së inovacioneve, e cila është integruar në mënyrë adekuate në dy module, kurse në një tjetër pjesërisht. Pra, sa i përket këtij drejtimi të studimeve mund të shohim se në 25 nga 41 module është realizuar një integrim adekuat apo i pjesërishëm i prioritetëve të agjendës evropiane, ndërsa në 16 lëndë nuk vërehet artikulum i qartë vëmendjes ndaj tyre.

Programi tjetër i studimeve paradiplomike të këtij fakulteti, Dizajni dhe konstruksioni i produkteve nga druri, ka gjithsej 39 module. Agjenda e Gjellbër këtu është integruar në mënyrë adekuate në dy module, ndërsa në shtatë lëndë ky integrim është i pjesërishëm. Digjitalizimi pokështu është integruar në mënyrë adekuate në dy module, ndërsa në pesë të tjera pjesërisht. Problematika e kërkimeve është integruar në mënyrë adekuate në dy module. Me një fjalë, vetëm në 18 nga 39 modulet kemi integrim adekuat apo të pjesërishëm të katër prioritetëve të agjendës evropiane.

Ndërkaq, programi i studimeve Master Arkitekturë dhe dizajn i interiorit me prodhime nga druri ka 23 module. Agjenda e Gjellbër është integruar vetëm pjesërisht në tre (3) nga këto module, ndërsa digjitalizimi është përfshirë në mënyrë adekuate në katër (4) module, kurse në gjashtë (6) të tjera pjesërisht. Inovacionet i shohim të integruara në mënyrë adekuate vetëm në një modul. Siç po shihet,

katër prioritetet në fjalë janë integruar në mënyrë adekuate apo pjesërisht në 18 nga 23 modulet e këtij programi të studimeve.

Fakulteti i turizmit dhe ambientit i USHAF ka vetëm një program të studimeve dhe atë në nivelin Master me titull Menaxhimi dhe inovacioni në turizëm. Ky program i studimeve ka 21 module. Në një nga këto lëndë shohim integrim adekuat të Agjendës së Gjellbër, ndërsa integrim të pjesërishtëm në dy module tjera. Digjitalizimi ndërkaq është përfshirë në mënyrë adekuate në dy module, ndërsa poashtu në dy të tjera pjesërisht. Problematika e inovacioneve është përfshirë në mënyrë adekuate në një modul. Në përgjithësi, katër prioritetet në fjalë të agjendës evropiane janë integruar në mënyrë adekuate apo pjesërisht në 12 nga 21 modulet e këtij programi të studimeve.

Programi i studimeve paradiplomike Dizajn grafik dhe multimedia pranë Fakultetit të Arteve të Aplikuara poashtu ka 21 module. Agjenda e Gjellbër dhe problematika e inovacioneve me sa duket nuk kanë gjetë vend në asnjë modul të këtij programi të studimeve. Ndërkaq, problematika e digjitalizimit është integruar në mënyrë adekuate në pesë (5) module, kurse në 14 të tjera është përfshirë pjesërisht. Në një modul kemi integrim adekuat të problematikës së hulumtimeve, ndërsa në dy të tjera mund të flitet për integrim të pjesërishtëm.

Pra problematika e digjitalizimit ose ajo e hulumtimeve janë integruar në mënyrë adekuate apo të pjesërishtëme në të gjitha modulet e këtij programi të studimeve, ndërsa Agjenda e Gjellbër dhe inovacionet nuk ka gjetur vëmendje të artikulluar në asnjërin nga këto lëndë mësimore.

Konkretisht, këto katër komponentë të agjendës evropiane janë integruar në mënyrë adekuate apo të pjesërishtëme në 171 nga 269 modulet e 8 programeve të studimeve të pesë fakulteteve të USHAF ose përafërsisht në tri të pestat e numrit të përgjithshëm të lëndëve mësimore të këtij IAL.

Këto statistika tregojnë për një tendencë zhvillimore e cila është rezultat i një vizioni e strategjie të artikulluar të zhvillimit të këtij universiteti. Siç shprehet një përfaqësues i këtij IAL “është në strategjinë e USHAF të punohet në aspektet e ekonomisë së qëndrueshme, digjitalizimit dhe inovacionit (shkencave të aplikuara).”<sup>5</sup> Kjo shihet qartë edhe nga struktura e programeve të studimit, përkatësisht nga planifikimi i moduleve të veçanta që tërësisht apo pak a shumë në mënyrë adekuate u kushtohen katër komponentëve të përmendura të agjendës evropiane.

#### **4.2. Shqyrtime përmbyllëse dhe përfundime**

Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) në Ballkanin Perëndimor, përfshirë Kosovën, po përballen me sfida dhe mundësi të mëdha në integrimin e tematikave prioritare të Bashkimit Evropian.

---

<sup>5</sup>Prof. dr. Bujar Pira, prorektor, përgjigjet e tij në “Pyetsorin mbi përfshirjen e elementeve të agjendës së gjellbër, digjitalizimit, hulumtimit dhe inovacionit në programe studimore”.

Rezultatet e kërimit tregojnë se, megjithëse ka hapa të hershëm në integrimin e temave si Inovacioni dhe Agjenda e Gjelbër në disa programe studimore, përgjithësisht këto elemente ende nuk janë përfshirë në mënyrë të mjaftueshme dhe të koordinuar në të gjitha fushat e studimit. Anketa me pjesëmarrësit nga IAL-të në Kosovë tregon se ka një konsensus për nevojën për përmirësime në strukturat kurrikulare dhe për investime më të mëdha në zhvillimin e kapaciteteve teknologjike dhe akademike.

Bazuar në gjetjet e raportit, rekomandimet për të përmirësuar situatën përfshijnë hartimin dhe përditësimin e kurrikulave në përputhje me Agjendën e Gjelbër, Digjitalizimin dhe Inovacionin, duke përfshirë një qasje ndërdisiplinore që i integron fushat e ndryshme të dijes. Për më tepër, investimi në infrastrukturë dhe teknologji është e nevojshme për të lehtësuar implementimin e këtyre temave në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Si nevojë është identifikuar edhe ndërtimi i partneriteteve të qëndrueshme me sektorin privat, organizatat jo-qeveritare dhe sektorin e hulumtimit për të siguruar që kurrikulat e IAL të jenë në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimeve globale.

Këto rekomandime synojnë të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë dhe në rajon, duke e bërë atë më të përshtatshme për sfidat dhe mundësitë e një bote të transformuar nga teknologjia dhe nevojat e një mjedisi të qëndrueshëm.

## ANNEX 1. UNIVERSITETET, PROGRAMET DHE NUMRI I MODULEVE TË VLERËSUARA

Universiteti	Fakulteti	Numri i Programeve të vlerësuara	Numri i Moduleve të Vlerësuara	Niveli i studimeve	
				Bachelor	Master
Universiteti i Prishtinës 'Hasan Prishtina'	Fakulteti Ekonomik	9	93	5	4
	Fakulteti i Edukimit	15	71	3	12
	Fakulteti i Arkitektures	3	49	1	2
	Fakulteti Filozofik	1	4	0	1
	Fakulteti Juridik	7	33	1	6
	Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore	11	156	6	5
	Fakulteti Mjekesise	3	56	3	0
	<b>Total</b>	<b>49</b>	<b>462</b>	<b>19</b>	<b>30</b>
Universiteti 'Isa Boletini'	Fakulteti Ekonomik	2	75	2	0
	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	2	113	3	0
	Fakulteti i Gjeoshkencave	3	130	3	0
	Juridik	1	59	1	0
	<b>Total</b>	<b>8</b>	<b>377</b>	<b>9</b>	<b>0</b>
Universiteti 'Ukshin Hoti' Prizren	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	2	64	2	0
	Fakulteti Juridik	1	32	1	0
	Fakulteti i Shencave te Jetes dhe Mjedisit	3	91	2	1
	Fakulteti Ekonomik	4	72	2	2
	Fakulteti i Edukimit	2	78	2	0
	<b>Total</b>	<b>12</b>	<b>337</b>	<b>9</b>	<b>3</b>
Universiteti 'Haxhi Zeka'	Fakulteti i Biznesit	6	136	3	3
	Fakulteti Juridik	2	47	1	1
	Fakulteti i Menxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit	2	67	2	0
	Fakulteti i Agrobiznesit	4	118	3	1
	<b>Total</b>	<b>14</b>	<b>368</b>	<b>9</b>	<b>5</b>
Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj	Fakulteti i Menaxhmentit	1	42	1	0
	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës	2	83	1	0
	Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit	3	103	2	1
	Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit	1	21	0	1
	Fakulteti i Arteve të Aplikuara	1	21	1	0
	<b>Total</b>	<b>8</b>	<b>270</b>	<b>5</b>	<b>2</b>



## **Anex 2 Intervistat me IAL**

- RIT Kosovo (A.U.K)-Mësimdhënëse
- Universiteti për Biznes dhe Teknologji-UBT
- Kolegji AAB-- Prorektore për Bashkëpunim të Jashtëm
- Universiteti 'Kadri Zeka'- Prorektore për Zhvillim Akademik dhe Cilësi
- Universiteti 'Kadri Zeka'-Prorektor për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë
- Universiteti i Prishtinës-Dekan-Fakulteti i Ndërtimtarisë
- Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Filozofik
- Universiteti i Prishtinës-Këshilltar i Rektorit
- Universiteti i Prishtinës- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike -Mësimdhënëse
- Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
- Universiteti i Prishtinës- Fakulteti i Arkitekturës
- Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj-Rektor
- Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj-Prorektor për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Sigurim të Cilësisë

## **Annex 3. Pyetësi**

### **Përfshirja e elementeve të Agjendës së Gjelbër, Digjitalizimit, Hulumtimit dhe Inovacionit në programe studimore**

Ky studim bëhet në kuadër të projektit 'Policy Answers' financuar nga ana e Komisionit Evropian në kuadër të programit 'Horizon Europe'. Qëllimi i këtij studimi është të hulumtojë përfshirjen e elementeve të Agjendës së Gjelbër, Digjitalizimit, Hulumtimit dhe Inovacionit në programet e studimeve, për të parë se si dhe sa janë reflektuar synimet strategjike të Agjendës së BE për Ballkanin Perëndimor në fushat e përmendura në përditësimet e programeve mësimore të IAL-ve në Kosovë.

**Ju lutemi të gjeni kohë për tu përgjegjur në pyetjet e mëposhtme dhe të kontribuoni në cilësinë e këtij studimi dhe në rekomandimet lidhur me avansimin e programeve studimore në IAL.**

Universiteti/ Kolegji:

Emri dhe mbiemri:

Pozita:

- 1. A keni zhvilluar module/lëndë të veçanta që përfshijnë elemente të Digjitalizimit, Agjendës së Gjelbër, Hulumtimit dhe Inovacionit në programet tuaja studimore:**
  - a) Po, tanimë kemi futur lëndë të reja në programet tona mësimore
  - b) Kemi hapur diskutimin dhe jemi në fillim të përgatitjeve
  - c) Jo, ende nuk kemi filluar ta trajtojmë këtë çështje

2. **“Agjenda e Gjelbër” është inkuadruar në kuadër të lëndëve/ moduleve si:**
  - a) Ekonomia qarkore trajtohet ne kuadër të:
  - b) Dekarbonizimi trajtohet ne kuadër të:
  - c) Ndotja e mjedisit trajtohet ne kuadër të:
  - d) Energjia ripërtëritëse trajtohet në kuadër të:
  - e) Sigurimi i ushqimit trajtohet në kuadër të:
  - f) Biodiverstiteti trajtohet në kuadër të:
3. **Digjitalizimi është inkuadruar në lëndë të veçanta ose në kuadër të lëndëve si (shëno lendet):**
4. **Hulumtimi dhe kërkimi përfshihen në lëndët/ modulet si:**
  - 4.1. **A përfshihet në syllabuset tuaja lënda Metodat Kërkimore:**
    - a) Po
    - b) Jo
  - 4.2. **Nëse po, sa kredi (ECT) ka kjo lëndë:**
  - 4.3. **Puna praktike dhe zhvillimi i shkathtësive realizohet përmes:**
    - Përvojës praktike në hulumtim
    - Seminareve/ punimeve
5. **Inovacioni përfshihet në lëndët/ modulet si:**
6. **Sipas vlerësimit tuaj, cilat janë barrierat dhe sfidat e përfshirjes së elementeve të digjitalizimit, hulumtimit dhe inovacionit në programet studimore. Ju lutem ti elaboroni disa prej këtyre barrierave dhe sfidave:**
7. **Ndonjë koment shtesë në lidhje me përfshirjen e elementeve të Agjendës së Gjelbër, Digjitalizimit, Hulumtimit dhe Inovacionit në programe studimore:**

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

Instituti Riinvest

## Annex 4. Referencat

DeSeCo. (2005). The Definition and Selection of Key Competences: Executive Summary. DeSeCo. Gjetur

nw:<https://www.deseco.ch/bfs/deseco/en/index/02.parsys.43469.downloadList.2296.DownloadFile.tmp/2005.dskcexecutivesummary.en.pdf>

European Commission (2021). Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions: 2030 Digital Compass: the European way for the Digital Decade/ Available at: [https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:12e835e2-81af-11eb-9ac9-01aa75ed71a1.0001.02/DOC\\_1&format=PDF](https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:12e835e2-81af-11eb-9ac9-01aa75ed71a1.0001.02/DOC_1&format=PDF)

European Union. (2019). Key Competences for Lifelong Learning. Publications Office of the European Union.

European University Association-eua (2023). A Green Deal roadmap for universities. Available at: <https://eua.eu/resources/publications/1078:a-green-deal-roadmap-for-universities.html>

Ferrari, A. (2012). Digital Competence in Practice: An Analysis of Frameworks. Publications Office of the European Union.

Jabbour, C. J. C., Sarkis, J., de Sousa Jabbour, A. B. L., & Govindan, K. (2013). Understanding the process of greening of Brazilian business schools. *Journal of Cleaner Production*, 61, 25-35.

Jain, S., Aggarwal, P., Sharma, N., & Sharma, P. (2013). Fostering sustainability through education, research and practice: a case study of TERI University. *Journal of cleaner production*, 61, 20-24.

Klimova, A., Rondeau, E., Andersson, K., Porras, J., Rybin, A., & Zaslavsky, A. (2016). An international Master's program in green ICT as a contribution to sustainable development. *Journal of cleaner production*, 135, 223-239.

Ministry of Higher Education and Science (2024). Understanding framework for green transition in education (Danish: Forståelsesramme for grøn omstilling i uddannelse). Available at: <https://ufm.dk/uddannelse/videregaende-uddannelse/temaer/gron-omstilling-i-uddannelser/forstaelsesramme/forstaelsesramme-for-gronne-omstilling-i-uddannelse.pdf>

OECD (2024), Cultivating the next generation of green and digital innovators: The role of higher education, *OECD Education Policy Perspectives*, No. 95, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/bb6e432e-en>.

Reichert, Sybille (2019). The Role of Universities in Regional Innovation Ecosystems. Available at: <https://eua.eu/downloads/publications/eua%20innovation%20ecosystem%20report.pdf>

Sánchez-Caballé, A., Gisbert Cervera, M., & Esteve-Mon, F. M. (2021). Integrating digital competence in higher education curricula: An institutional analysis. *Educar*, 57(1), 0241-258.

Stöber, Henriette, Gaebel, Michael and Morrisroe, Alison (2021). Greening in European higher education institutions. EUA survey data. Available at: <https://eua.eu/downloads/publications/greening%20report.pdf>

Uvalić, Milica (2022). Implementing the Green Agenda in the Western Balkans: Just Transition and Political Barriers. In Green Agenda for the Western Balkans. The Road Toward Effective and Sustainable Implementation. Aspen Institute Deutschland.

VET Toolbox Coordination Hub (2023). Skills for the Green Transformation Toolkit. Available at: [https://vettoolbox.eu/wp-content/uploads/2023/01/S4GT\\_Toolkit.pdf](https://vettoolbox.eu/wp-content/uploads/2023/01/S4GT_Toolkit.pdf)

World Economic Forum. (2023). Future of Jobs Report: Insight Report . World Economic Forum.

Denmark's Evaluation Institute (2022). Nine examples of green transition in higher education (Danish: Ni eksempler på grøn omstilling i videregående uddannelser En caseundersøgelse af grønt læringsudbytte på videregående uddannelser). Link: <https://ufm.dk/publikationer/2022/filer/casekatalog-ni-eksempler-pa-gron-omstilling-i-videregaende-uddannelser.pdf>